

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6-18

MIKI Konstruksion Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVE			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	423,509	973,256
Llogari të arketueshme tregtare	5	1,206,592	249,192
Të tjera llogari të arkëtueshme	6	51,254	52,450
Total aktive afatshkurtra		1,681,355	1,274,898
Aktivët afatgjatë			
Aktive afatgjatë materiale	7	3,006,175	3,292,449
Total aktive afatgjatë		3,006,175	3,292,449
Total aktive		4,687,530	4,567,347
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	8	1,102,554	899,133
Detyrime tatimore	9	8,004	126,688
Të tjera detyrime	10	483,653	-
Total detyrime afatshkurtra		1,594,211	1,025,821
Detyrime afatgjatë			
Total detyrime afatgjatë		-	-
Totali i detyrimeve		1,594,211	1,025,821
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar	11	100,000	100,000
Rezerva ligjore		234,637	232,551
Rezerva të tjera		3,206,889	3,595,051
Fitimi i ushtrimit		(448,207)	(386,076)
Total kapitali		3,093,319	3,541,526
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		4,687,530	4,567,347

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MIKI Konstruksion Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	12	2,482,500	2,707,660
Lënda e pare dhe materiale të konsumueshme		(1,527,356)	(2,664,794)
1) Lënda e pare dhe materiale te konsumueshme	13	(1,399,610)	(2,636,044)
2) Të tjera shpenzime	14	(127,746)	(28,750)
Shpenzime të personelit	15	(1,117,142)	(424,788)
1) Paga dhe shpërblime		(957,276)	(364,000)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore dhe shëndetsore		(159,866)	(60,788)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	7	(286,274)	-
Shpenzime/të ardhura financiare neto	16	65	(1,958)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		65	-
2) Shpenzime të tjera financiare		-	(1,958)
Fitimi/(humbja) para tatimit		(448,207)	(383,880)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	17	-	(2,196)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		-	(2,196)
Fitimi/humbja e vitit		(448,207)	(386,076)


Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

MIKI Konstruksion Sh.p.k*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitim/ humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2018	100,000	232,551	3,900,077	(305,026)	3,927,602
Fitimi/humbja e vitit	-	-	-	(386,076)	(386,076)
Lëvizjet përmes kapitalit	-	-	(305,026)	305,026	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2019	100,000	232,551	3,595,051	(386,076)	3,541,526
Fitimi/humbja e vitit	-	-	-	(448,207)	(448,207)
Lëvizjet përmes kapitalit	-	2,086	(388,162)	386,076	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2020	100,000	234,637	3,206,889	(448,207)	3,093,319

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 u aprovuan dhe u nënshkruan si më poshtë më 24 mars 2021:



Afërdita Dukaj
Administrator



**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukset e parasë nga/(përdorur në) aktivitetet operative		
Fitim/humbja e vitit	(448,207)	(386,076)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	286,274	-
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(956,204)	(255,417)
Rënie/(rritje) në inventarë	-	1,145,864
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	87,737	212,605
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	480,653	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	(549,747)	716,976
Fluksi i parasë nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	-	-
Fluksi i parasë nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	-	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(549,747)	716,976
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	973,256	256,280
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	423,509	973,256

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 18, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

(Vlerat janë në Lek)

1. Informacion i përgjithshëm

“Miki Konstruksion” sh.p.k (Kompania) është regjistruar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar më 03 Maj 1995. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek, i ndarë në 1 kuotë.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është projektimi, ndërtimi, zbatimi e objekteve në fusha të ndryshme si: ndërtesa për hoteleri, rrugë ujësjellës-kanalizime dhe të gjitha llojet e ndërtimeve.

Selia e shoqërisë është në adresën: Lagjja Vasil Shanto, Rruga Vaso Kadia, godine nr 1/506, Shkoder. Më 31 dhjetor 2020 Shoqëria kishte 1 punonjës (2019: 4 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.25/2018, datë 10 maj 2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrin nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdher hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119 datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale.

Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga paaftësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çrregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit që mund të masë me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.5.3. Gjykime dhe vlerësime mbi efektet e pandemisë në parimet e vijimësisë

Ndërsa situata pandemike COVID-19 ende po evoluon në Shqipëri dhe në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, manaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumi i shitjeve, fluksi i parasë, (zhvlerësimi i aktiveve, inventari, vlera e drejtë, etj..) dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

3. Politikat kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisht të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.1. Transaksionet në monedhë të huaj (vazhdim)**

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2020 dhe 2019 është detajuar si më poshtë:

<u>Kursi i këmbimit</u>	<u>2020</u>	<u>2019</u>
Euro/ALL	123.70	121.77
USD/ ALL	100.84	108.64

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë.

Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitetet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.2 Instrumentat financiarë (vazhdim)

Huatë e marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi. Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

*(Vlerat janë në Lek)***3. Politikat kontabël (vazhdim)****3.4. Aktive afatgjata materiale***i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundur që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje dhe orendi	Vlerë e mbetur	20%
Pajisje informatike	Vlerë e mbetur	25%
Makineri dhe pajisje	Vlerë e mbetur	20%
Automjete	Vlerë e mbetur	20%
Të tjera	Vlerë e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat nga shitja e banesave

Të ardhurat regjistrohen sipas masës së realizimit të tyre dhe lidhjes që ato kanë me ushtrimin e mbyllur kontabël, pavarësisht nëse arkëtimi i tyre apo i një pjese prej tyre do të ndodhë në një ushtrim pasardhës.

Të ardhurat janë përfitimet ekonomike bruto (pa TVSH dhe zbritjet tregtare), të marra gjatë periudhës kontabël, si rezultat i rrjedhës normale të veprimtarisë së njësisë ekonomike raportuese, atëherë kur këto përfitime ekonomike çojnë në rritjen e kapitaleve të veta.

Politika kontabël zbatohet nga shoqëria në lidhje me njohjen e të ardhurave nga shitja e banesës janë të regjistruara me vlerat e përlllogaritura si më poshtë:

Deri në momentin e përfundimit të ndërtimit të banesave në të ardhura regjistrohet vlera neto e realizimit të punimeve pa TVSH, shume e cila e cila përfaqëson koston për ndërtimin e banesës plus një diferencë prej 7% si fitim i përlllogaritur, në respektim të kërkesave të legjislacionit tatimor në fuqi.

TVSH prej 20% aplikohet gjatë fazës së ndërtimit, mbi koston e ndërtimit në proces dhe (plus) marzhin prej 7% fitim. TVSH nuk aplikohet për diferencën e çmimit të shitjes përfundimtare të banesës minus totalin e koston të ndërtimit në proces plus marzhin e fitimit prej 7% dhe TVSH-së.

Kur konsiderohet se të ardhurat nga shitja e banesës janë të sigurta, diferenca midis çmimit të shitjes sipas kontratës së shitjes me klientin dhe koston të ndërtimit plus marzhin e fitimit 7% u shpjegua më lart njihet si e ardhur. Të ardhurat konsiderohen të sigurta nga shoqëria, kur blerësi ka paguar 75-90% të çmimit të kontratës. Blerësve i kerkohet të paguajnë deri në këtë nivel (sipas kontrates), kur prona është fizikisht e plotë dhe e gatshme për t'iu dorëzuar klientit. Pagesat e mbetura të 25-10% shlyhen kur titulli ligjor i pronësive transferohet tek blerësi.

Për kontratat e ndërtimit

Te ardhurat nga kontratat e ndërtimit përbëhen nga vlera fillestare për të cilën është rënë dakort në kontratë dhe (a) shuma e variacioneve për punën e kontraktuar; (b) pretendimet (claim-et); (c) pagesat stimuluese të njohura në atë masë në të cilën ato mund të konsiderohen si të ardhura dhe të vleësohen në mënyrë të besueshme.

Kur rezultatet e një kontrate ndërtimi mund të vlerësohen me besueshmëri, të ardhurat dhe kostot e lidhura me kontratën e ndërtimit do të njihen si të ardhura dhe shpenzime respektivisht me fazën e realizimit të punimeve në datën e bilancit, e njohur kjo dhe si metoda e përqindjes së realizimit. Përqindja e realizimit është llogaritur mbi bazën e përqindjes së kostove faktike në datën e bilancit me kostot totale të vlerësuara të kontratës. Sipas kësaj metode, të ardhurat e kontratës krahasohen me kostot që janë kryer për të arritur në këtë fazë të realizimit të kontratës, duke rezultuar në raportimin e të ardhurave, shpenzimeve dhe fitimit që i atribuohen pjesës së punës së kryer.

(Vlerat janë në Lek)

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.5. Të ardhurat (Vazhdim)

Sipas metodës së përqindjes së realizimit, të ardhurat e kontratës janë njohur si të ardhura në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, për periudhën kontabël në të cilën është realizuar puna. Kostot e kontratës njihen si shpenzime në Pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, në periudhën kontabël në të cilën puna (për të cilën ato janë bërë) është kryer.

Metoda të tjera të pranueshme të njohjes së të ardhurave dhe kostove, nga kontratat e ndërtimit janë ato përmes inspektimit të punës së kryer si dhe nivelit të plotësisht të një pjese fizike të punës së kontraktuar.

Për kontratat e bazuara në volumin e punimeve me cmime të përcaktuara

Të ardhurat janë njohur bazuar në volumin e realizuar të punës me cmimet e caktuara të kontratës dhe kostot janë njohur bazuar në kostot e shfaqura gjatë realizimit të fazës së punimeve.

Të ardhurat e tjera kryesisht konsistojnë nga të ardhurat nga interesi. Këto të ardhura janë gjeneruar nga depozitat në banka dhe njihen me maturimin e tyre, atëherë kur interesi arkëtohet sic kërkohet nga legjislacioni tatimor.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3. Politikat kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 5% (2019: 5%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivitet dhe Detyrimet e Kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

*(Vlerat janë në Lek)***4. Mjete monetare**

Mjetet monetare në arkë dhe bankë më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare në bankë	423,509	973,256
Llogari rrjedhëse	423,509	973,256
	<u>423,509</u>	<u>973,256</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Klientë	1,206,592	249,192
	<u>1,206,592</u>	<u>249,192</u>

6. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim mbi fitimin	50,254	52,450
TVSH e kreditueshme	1,000	-
	<u>51,254</u>	<u>52,450</u>

MIKI Konstruksion Sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020
(Vlerat janë në Lek)
7. Aktive afatgjata materiale

	Ndërtesa	Makineri dhe pajisje	Të tjera	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,894,228	1,194,345	213,660	4,302,233
Shtesa	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	2,894,228	1,194,345	213,660	4,302,233
Shtesa	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2020	2,894,228	1,194,345	213,660	4,302,233
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	412,789	506,403	90,592	1,009,784
Amortizimi i vitit	-	-	-	-
Gjëndja më 31 dhjetor 2019	412,789	506,403	90,592	1,009,784
Amortizimi i vitit	124,072	137,588	24,614	286,274
Gjëndja më 31 dhjetor 2020	536,861	643,991	115,206	1,296,058
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2018	2,481,439	687,942	123,068	3,292,449
Gjendja më 31 dhjetor 2019	2,481,439	687,942	123,068	3,292,449
Gjendja më 31 dhjetor 2020	2,357,367	550,354	98,454	3,006,175

8. Llogari të pagueshme tregtare

Llogaritë e pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Furnitorë vendas	1,102,554	899,133
	1,102,554	899,133

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	7,254	29,016
Tatim në burim	750	750
TVSH për t'u paguar	-	96,922
	8,004	126,688

*(Vlerat janë në Lek)***10. Të tjera detyrime**

Detyrimet e tjera për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Detyrime ndaj personelit	480,653	-
Të tjera detyrime	3,000	-
	<u>483,653</u>	<u>-</u>

11. Kapitali themeltar

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek, i ndarë në 1 kuotë.

Ortaku I shoqërisë është:

- Gazmend Hasi, zotërues I 1 kuote ose 100 % të kapitalit të Shoqërisë

Humbja e vitit ushtimor që u mbyll më 31 dhjetor 2020 është: 448,207 lekë (Humbja e 2019: 386,076 lekë).

12. Të ardhura nga aktiviteti I shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga ndërtimi	2,482,500	2,707,660
	<u>2,482,500</u>	<u>2,707,660</u>

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së dhe Tatim Fitimit.

	<u>31 dhjetor 2020</u>
Rakordimi i te ardhurave me FDP-në	
Shitje totale të deklaruara në FDP-në e TVSH-së	2,482,500
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	2,482,500
Të ardhura nga ndërtimi	2,482,500
Të ardhura të deklaruara në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	2,482,500
Fitim nga këmbimet valutore	65
Total të ardhura të deklaruara në FDP-në e Tatim Fitimit	<u>2,482,565</u>

*(Vlerat janë në Lek)***13. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme**

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara që lidhen më veprimtarinë e shfrytëzimit. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Kosto e materialeve të para	1,399,610	2,636,044
	<u>1,399,610</u>	<u>2,636,044</u>

14. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime qiraje	9,000	28,750
Shpenzime administrative dhe noteriale	4,450	-
Konsulenca ekonomike dhe juridike	5,000	-
Taksa te ndryshme	98,800	-
Komisione bankare	8,300	-
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	2,196	-
	<u>127,746</u>	<u>28,750</u>

15. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit paraqiten si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime për paga	957,276	364,000
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	159,866	60,788
	<u>1,117,142</u>	<u>424,788</u>

16. Shpenzime financiare

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit dhe rezultatin nga kursi i këmbimit që lidhet me aktivitetin financiar të shoqërise. Ky zë detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019</u>
Të ardhura nga interesat	65	-
Shpenzime të tjera financiare	-	(1,958)
	<u>65</u>	<u>(1,958)</u>

17. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Fitimi para tatimit	(448,207)	(383,880)
Shpenzime të panjohura:	<u>2,196</u>	<u>427,800</u>
Shpenzime të panjohura të tjera	2,196	427,800
Fitimi para tatimit (përfshire shpenzimet e panjohura)	(446,011)	43,920
Tatim fitimi 5%	-	2,196
	<u>(448,207)</u>	<u>(386,076)</u>

18. Angazhime dhe pasiguri

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërise, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të kenë efekt negativ në pozicionin financiar të shoqërise ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Më 31 dhjetor 2020 shoqëria nuk ka angazhime kapitale të kontraktuara por ende të papaguara.

19. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit që kërkojnë rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.